

ERARBA ÇIRAKU

“VEPRA E BOGDANIT 1675-1685” E IBRAHIM RUGOVËS, SI QASJE DHE PËRBALLIM TEZASH

Në kritikën letrare shqiptare, Ibrahim Rugova mbetet nga zërat më të shquar. Këtë e dëshmon përballimi prej tij i disa prej temave kyçe në studimin e letërsisë shqipe, e dëshmon po ashtu thellësia, kompetenca e fushës, njohja dhe zbatimi i metodave interpretuese më të reja / më bashkëkohëse, si dhe ndjekja sistematike, me shije dhe intuitë selektimi të proceseve letrare. Është nga ata studiues që tashmë mbetet i shenjuar me disa arritje antologjike në korpusin e studimeve letrare shqiptare. Këtu hyjnë evidentimi sistematik i konceptit të tij për *refuzimin estetik* në letërsi – si domeni i vetëmjaftueshëm për të verifikuar vlerat reale letrare; po kështu ndjekja e modelit të kritikut – që priret për nga dekodimi i strukturave tekstore, duke i parë ato struktura si pjesë të sistemit letrar e jo në qarqe të mbyllura. Rugova është nga ata studiues të rafinuar, i cili, e ka të kalkuluar strategjinë e hulumtimit, me prirjen e modelimit përgjithësisht të një artikulimi në nivel teorik rreth krijimtarisë letrare, si dhe në njohjen dhe përcaktimin e drejtë hierarkik të atyre veprave letrare – që për nga vlerat e tyre përfaqësuese, i kapërcejnë kornizat kohore.

Studimi i tij monografik *Vepra e Bogdanit 1675-1685* (1982), do të vinte pas disa botimeve të mëparshme si: *Prekje lirike* (1971), *Kah teoria* (1978) e *Strategjia e kuptimit* (1980). Objekt studimi këtu bëhet vepra *Çeta e profetëve* (*Cuneus Prophetarum*) e Pjetër Bogdanit, e cila, në botimin e saj të parë u shtyp në Padova të Italisë, më 1685. Për nga struktura, studimi ndahet në dy pjesë: *Gjenetika e veprës* dhe *Analitika e veprës*. Secila prej këtyre pjesëve përmban një mori çështjesh, tezash e hipotezash, ku vërehet një informacion i dendur letrar, filozofik, kulturor, religjioz, jetëshkrimor, bibliografik, historik, mjedisor, informacion ky që vjen prej kohës së shkrimit të veprës bogdaniene, por edhe i kohëve më të vonshme,

deri në bashkëkohësi. Pra, shqyrtimi i veprës ndjek një trajektore të hapur, për ta bërë vërtet bindëse tezën e studiuesit se kjo vepër, jo vetëm që arriti t'i shfaqte në nivelin më të lartë për kohën vlerat e saj letrare, por që inauguron edhe themelin e humanizmit shqiptar dhe se në një farë mënyre mund të përcaktohet/vlerësohet si *Komedia hyjnore shqiptare*. Sikundër kanë vërejtur studiuesit, tek ky studim rindërtohet gjenetika dhe artikulohet në mënyrë bindëse analitika sistimore e këtij autori të hershëm shqiptar, i cili, me të drejtë mund të përcaktohet i njëjtë me autorët e lëvizjeve humaniste europiane të kohës, qoftë për nga koha kur u shkrua, qoftë për nga idetë qarkulluese në të¹

Autori i veprës së Bogdanit rezulton të jetë mjaft sistematik në dhënien e informacionit, duke mos e parë atë rrjet të dendur të dhënash thjesht si një bllok inventarizues, por në funksionin metodik – për t'iu dhënë sa më bindshëm mbështetje tezave e përfundimeve të veta dhe ndërkaq, për ta dëshmuar atë *përvujtëni* të dijetarit, që di t'ua njohë dhe t'ua vlerësojë fort kontributet të tjerëve. Kështu, ai sjell në vëmendje studimet e autorëve të huaj, por edhe atyre shqiptarë që janë marrë me këtë vepër si: Ndre Mjedja, Justin Rrota, Filip Fishta, Eqrem Çabej, Selman Riza, Martin Camaj etj.² Madje, qysh në hyrje të librit, ai ka përzgjedhur e vendosur një kolazh antologjik të disa prej këtyre vlerësimeve rreth veprës bogdaniene. Kështu Shtjefën Gjeçovi e cilëson këtë një vepër monumentale, dritë e *literatyrës shqiptare*, që ia zbardhi faqen vendit e atdheut. Kurse Lasgush Poradeci, i cili do ta njihnte atë vepër në vitet kur ishte ende student në Vjenë, do të mrekullohej aq shumë, sa që një prej poezive kozmogonike bogdaniene, të cilën e kopjoi me dorë, do ta vlerësonte nga pikëpamja e konceptimit origjinal dhe e idesë së fuqishme dhe

¹ S. Hamiti, Studim hyrës tek I. Rugova, *Prekje lirike*, Prishtinë, 2005.

² Shih:

-J. Rrota *Leteratyra shqype*, 1925.

-E. Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, 1936.

-L. Poradeci, *Poezi, et coetera...* 1943.

- *Shkrimtarët shqiptarë I*, 1941.

formës së veçantë, si monument letrar, jo vetëm i gjuhës shqipe, por i republikës së letrave përgjithësisht.³

Pjesa e parë e studimit jep një informacion të pasur rreth kontekstit historik e kulturor, ku u formua personaliteti i këtij humanisti të shquar, tek i cili zotëronte një kulturë mjaft e gjerë, me njohje të thellë të veprave të dijetarëve të kohës, por dhe të qytetërimeve të lashta të lindjes, apo greke dhe romake. Studiuesi sjell në vëmendje dijet e plota që zotëronte Bogdani në filozofi, në kulturë e gjuhë, duke sjellë në vëmendje se ai ndërkaq njihte gjuhët e vjetra: hebraishten, sirianishten, arabishten, greqishten e vjetër, latinishten, armenishten dhe po ashtu italishten, gjermanishten e frëngjishten. Pra, ishte një personalitet me formim të lartë e solid, tek i cili, do të vinte natyrshëm edhe motivimi i shkrimit të një vepre tërësore dhe fundamentale për nga vlerat që ajo mbart, sikundër është *Çeta e profetëve*. Në këtë pjesë sillet informacion i hollësishëm edhe rreth gjashtë botimeve të kësaj vepre gjatë tre shekujve, duke nisur nga i pari në vitin 1685 në Itali, e deri tek ai më i fundit, i vitit 1977 në Gjermani. Këtu prezantohen fakte rreth situatave që shoqërojnë këto botime, qysh me lejet e kërkuara nga sekretaria e Kongregacionit, pastaj me luhatjet e titullit të veprës, me kontratat shtypshkrimore dhe raportet financiare e raportet me censurën. Këto informacione nuk mbeten qëllim në vetvete, por dëshmojnë që të përcjellin sa më besnikërisht dinamikën e kësaj vepre si botim/tekst, por edhe si kompleks / tërësi rrethanash përcjellëse / mbërritëse – për tek lexuesi, në kohë dhe në vende të ndryshme.

Kurse në pjesën e dytë të studimit formulohen disa nga tezat themelore, që besojmë se hidhen për herë të parë rreth veprës së Bogdanit. Kështu, krahas frymës dhe mistikës biblike tek *Çeta e profetëve*, Rugova vëren edhe elemente të mirëfillta të ligjërimit artistik, me forcë abstraguese, emocionale dhe imagjinative, që e shtyjnë ta gjykojë atë si biografi të romanësuar, pra, ku shfaqen madje dhe konturet e romanit të parë shqiptar⁴. “Veti kryesore e kësaj proze është se realizohet kryesisht përmes rrëfimit artistik në

³ I. Rugova, *Vepra e Bogdanit*, f. 8, 2005.

⁴ Y. Çiraku *Shqyrtime kritike nga historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 2011, f. 219.

*veta të ndryshme të ligjëratës dhe përmes saj, ngrihet figura e personazhit kryesor dhe e personazheve të tjerë ...pastaj vend të rëndësishëm zë përshkrimi si teknikë artistike.*⁵

Duke e cilësuar këtë vepër si bërthamë të romanit të parë shqiptar, Rugova nxjerr në pah edhe dritën dhe shkëlqimin që shpaloset në të, në kontrast me traditat kanonike të kohës, duke arritur në bindjen se shikuar në këtë plan, e gjithë vepra duket së brendshmi si një metaforë solare, ku çdo fenomen e gjykim, kërkohet dhe vendoset brenda refleksit të dritës, të burimit të saj, diellit.⁶

Në këtë pjesë studiuesi shqyrton si problematikë një varg çështjesh themelore që i përcjell kjo vepër: mbi filozofinë e njeriut, të natyrës e gjuhës, mbi kategoritë estetike, mbi kohën dhe hapësirën, poetikën, retorikën e semiotikën. Në këtë zinxhir të ngjeshur problemesh, nuk mungojnë as klasifikimet tipologjizuese mbi modelet e prozës shkencore e prozën artistike që vepra sugjeron, mbi kozmogoninë dhe deri polemikën e brendshme që vepra projekton – pasi pranohet se Bogdani e kishte mjaft të fortë kultin e dijes, si energji intelektuale e njeriut, që lind e rritet në procesin e natyrshëm të refuzimeve dhe tejkalimeve, në raport me traditën – por dhe me konceptet qarkulluese të kohës.

Një tezë e fortë është përcaktimi i veprës së Bogdanit si *fundament i modernitetit tonë intelektual e ekzistencial*. Këtë tezë studiuesi e argumenton me faktin se kemi të bëjmë me një nga ato vepra që vërtet vlerësohen se parashtrajnë analiza e zgjidhje të rëndësishme, të cilat me kalimin e kohës natyrshëm edhe vjetrohen, por që vlerësohen e mbartin vlera esenciale mbi të gjitha për shtytjet, apo *stimulanset* paravajtëse, si i quan ai.⁷

Pra, vepra të tilla çmohen për vlerat e pritshme që ato përcjellin nëpër epoka. Dhe pikërisht *Çeta e profetëve*, klasifikohet për akribi të lartë shkencore prej Rugovës, si vepra që dëshmohet sot për sot si themeli i humanizmit shqiptar, i modernitetit intelektual, si bërthama

⁵ I. Rugova Vepra e Bogdanit 1675-1685, Tiranë, f. 193.

⁶ Po aty, f. 229.

⁷ Po aty, f. 192.

“Vepra e Bogdanit 1675-1685” e Ibrahim Rugovës, si qasje dhe përballim...

e romanit të parë shqiptar apo dhe deri si variant i titulluar: *Komedia hyjnore shqiptare*. Këto janë teza vërtet mjaft të forta, që studiuesi i përballon bindshëm me një metodikë dhe një pasion të ngulët hulumtues dhe interpretues.

BIBLIOGRAFI

Pjetër Bogdani dhe vepra e tij, Tiranë, 1991.

Plasari, A., *Bogdani siç nuk është*, HDT, nr. 5-6, 1994, f. 18-27.

Rugova, I., *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare*, Tiranë, 1996, f. 29-38.

Sinani, Sh., *Midis dy rilindjeve P. Bogdani dhe vepra e tij...*, Sipërrore, Tiranë, 1998, f. 19-27.

Shkrimtarët shqiptarë, pjesa I, Tiranë, 1941 (Shih Justin Rrota *P. Bogdani. Kryevepra*).

Shuteriqi, Dh., *Mbi P. Bogdanin dhe veprën e tij*, Nëntori, nr. 12, 1989.

